

## **Informacion i shkurtër për zbatimin e gjobave**

Ju jeni dënuar me një gjobë me vendim gjykatë të formës së prerë. Në parim, gjoba duhet paguar njëherësh brenda afatit të përmendur në faturë.

### **Lehtësimet e pagesës**

#### **Pagesa me këste**

Nëse ju nuk jeni në gjendje ta paguani njëherësh të gjithë shumën, ekziston mundësia e pagesës me këste. Për këtë duhet bërë kërkesë me shkrim në prokurorinë publike përkatëse duke treguar numrin e dosjes dhe njëkohësisht duke paraqitur provat. Një formular për kërkesën me shkrim për pagesën me këste është i disponueshëm në prokurorinë publike ose në faqen e saj online në internet.

#### **Shtyrja e afatit**

Pagesa e gjobës në raste përjashtuese në kushte të caktuara paraprake edhe mund të shtyhet nga afati, kjo do të thotë të shtyhet, nëse për shembull prisni së shpejti një shumë më të madhe ose nëse filloni një punë. Edhe për këtë është e nevojshme një kërkesë me shkrim në prokurorinë publike duke treguar numrin e dosjes dhe duke paraqitur provat.

### **Mospagesa**

#### **Mbledhja**

Nëse nuk paguani, prokuroria publike mund të lëshojë një urdhër përmbarimi, që do të thotë të ngarkojë me punë përmbaruesin që të kryejë sekuestrimin.

#### **Dënimi me heqje lirie si kompensim**

Nëse gjithçka përfundon pa sukses, ju do të thirreni në një institucion korrektues për të filluar dënimin me heqje lirie si kompensim. Nëse vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë përpara datës 1 shkurt 2024, për çdo masë ditore të gjobës duhet të kryhet një ditë burgim. Në rastin kur vendimi ka marrë formë të prerë duke filluar nga data 1 shkurt 2024, një ditë burg në parim do të zëvendësojë dy tarifa ditore të gjobës. Nëse nuk ofroheni vullnetarisht, atëherë del urdhri i arrestit dhe policia ngarkohet me punë për t'ju marrë.

**Nëse gjoba (e mbetur) paguhet, atëherë jeni përsëri i lirë.**

### **Punë në komunitet**

Sipas rregullores së shlyerjes, prokuroria publike, në kushte të caktuara paraprake, mund t'ju lejojë të shmangni zbatimin e dënimit me heqje lirie si kompensim duke kryer punë të pavarur. Si rregull, gjashtë orë punë në komunitet korrespondojnë me një ditë heqje lirie si kompensim. Edhe për këtë duhet të bëni një kërkesë me shkrim në prokurorinë publike duke treguar numrin e dosjes. Një formular për kërkesën me shkrim për shlyerjen e pagesës nëpërmjet punës në komunitet është i disponueshëm në prokurorinë publike ose në faqen e saj online në internet. Në rastin e kërimit të një vendi pune zëvendësuese ju mund të mbështeteni nga ndihma gjyqësore ose zyra të pavarura.